



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT  
PERMBARUES GJYQËSOR "ALDO F.GJEVORI"

Adresa :Lagja 'Kongresi Elbasanit', Rruga "Koco Brisku" pallati perballe 'Gjykates' Elbasan ,kati i parë, Tel.054 2 46377 E-mail aldo\_gjevori@yahoo.com

Nr.387-4 Regj

Elbasan, më 07.04.2022

URDHËR  
"PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"



Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit. ✓  
Adresa : Tiranë

Drejtuar : Shoqëria "BIRRA TIRANA" Sh.a , Nuis : J61821051F  
Adresa : Rruga Konferenca e Pezës , Tiranë

Për dijeni : Shoqëria "BETA" Sh.p.k , Nuis : J92705207V,me Adm z Bexhet Kapllani  
Adresa : Fshati "Bradashesh" Elbasan

Pranë Përmbaruesit Gjyqësor Privat "Aldo Gjevori" me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarimore me numer 387 Regj., me pale:

Kreditor : Shoqëria "Beta" Sh.p.k , Nuis : J92705207V,me Adm z Bexhet Kapllani  
Debitor : Shoqëria "BIRRA TIRANA" Sh.a , Nuis : J61821051F  
Objekti : Likujdim fature tatimore dhe pagesë kamatash ligjore

KONSTATOVA:

Në vazhdim të procedurave përmbarimore , për ekzekutimin e "Titullit Ekzekutiv" ( fature tatimore shitje ) nr. 68 date 25.06.2018 , Nr.Serie 27595237 , lëshuar nga Shoqëria "BETA" Shpk , Nuis : J92705207V , me Administrator z.Bexhet Kapllani , për të cilën është lëshuar Urdheri Ekzekutimit Nr 16664/4771 date 01.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pasi kanë kaluar afatet e parashikuara në nenin 517 K.Pr.Civile dhe është konstatuar se debitori nuk e ka përmbushur detyrimin sipas dispozitivit të Titullit Ekzekutiv.

Ne baze të nenit 519 të K.Pr.Civile, nga ana e jonë është marre vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrueshem duke vendosur masën e sekuestros mbi aktivet e palës debitore.

Për këtë arsye :

Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

URDHËROJ :

- 1-Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi aktivet e palës debitore : Shoqëria "BIRRA TIRANA" Sh.a , Nuis : J61821051F , me qëllim mostjetersimin e tyre , si dhe mos kryerjen e çdo veprimi që do të sjellë ndryshime në regjistrin tregtar .
- 2-Aktivitetet e mesiperme do të qendrojnë të sekuestruara deri në një urdhërese të dytë nga ana e jone.
- 3-Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 4-Per personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren të gjitha masat e parashikuara në neni 598 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohej ndjekje penale në baze të dispozitivave të Kodit Penal.
- 5-Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në baze të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

Ju faleminderit ,

PËRMBARUESI GJYQËSOR

ALDO GJEVORI

